



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 1006/2 Prot.

Berat më, 09.04.2026

Lënda: Kërkesë për shpallje publike (të vendimit për shpalljen debitor)

Drejtuar : DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE  
DEPARTAMENTIT TË ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORIT TË MONITORIMIT TË BORXHIT

Drejtuar : DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: "Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjja; Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra;  
"Pajtoni Bussines Center", kati 5. "

Bazuar në Nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe pikës 4 të Nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë": "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe...";

Kërkojmë shpalljen publike të vendimit administrativ për shpalljen debitor ndaj:

Operatorit ekonomik: "SHOESERY - SHPK" shpk, me Nipt:L930270011  
Vendimi Nr. 33 datë 03.04.2026: Detyrimi doganor 9,952 Lekë  
Penaliteti 29,856 Lekë

Kjo kërkesë bëhet për faktin se operatorit nuk ka marrë njoftim në adresën e deklaruar dhe për vazhdimin e procedurave të tjera ligjore është e nevojshme shpallja publike dhe data e shpalljes publike.  
(Bashkëlidhur vendimi Nr.33 datë 03.04.2026 i Degës Doganore Berat.)

Ju falenderojmë për bashkëpunimin !

KRYETAR I DEGËS DOGANORE BERAT



Adresa: Ish Kombinati i Tekstileve, Berat

www.dogana.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 938/2 prot.

Berat, më 03.04.2026

NJOFTIM VENDIMI

Personi fizik: "SHOESERY SHPK" shpk, me Nipt:L930270011, Rruga Novruz Aznedari, godine dykateshe, prane Xhamise, Berat

Në vijim të verifikimeve të kryera nga autoritetet Degë Doganore Berat është konstatuar: Kundërvajtje administrative doganore

Për këto arsye:

Ju me Vendimin Nr. 33, datë 03.04.2026 (bashkëngjitur) jeni shpallur debitor për:

• Detyrimin doganor	9.952	Lekë
• Penalitetet :	29.856	Lekë
Total	39.808	Lekë

Sa më sipër kërkohet paraqitja juaj pranë Degës Doganore brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për ekzekutimin vullnetar të vendimit të sipërcituar, në të kundërt Administrata Doganore do të ndërmarë procedurat ligjore për rikuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara.

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT



Një kopje e kësaj letrë është dorëzuar më datë \_\_\_\_\_ pranë Qendrës së Shoqërisë dhe agjentit doganor të përmendur këtu më sipër.

Firma e marrësit (ose në rastin e personit juridik e përfaqësuesit)	Marrësi nuk gjendet Shkresa e njoftimit dorëzuar:	Marrësi/personat e tjerë të përcaktuar nga ligji refuzojnë të nënshkruajnë.
	Firma e _____ (Shënoni lidhjen e këtij personi me marrësin)	Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari
		Nëpunësi që bën njoftimin/dëshmitari

Adresa: "Ish Kombinati i Tekstileve, Berat"

www.dogana.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BERAT

Nr. 938/1 prot.

Berat, më 03.04.2026

VENDIM NR.33

Sot më datë 03.04.2026 në rolin e Autoritetit Vendimmarrës të Degës Doganore Berat, pasi shqyrtova Procesverbalin e konstatimit Nr. Serial 0006760 datë 06.03.2026 ose me Nr.666 Prot. datë 06.03.2026 të mbajtur nga doganieret e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit: "SHOESERY SHPK" shpk, me Nipt:L930270011, Rruga Novruz Aznedari, godine dykateshe, prane Xhamise, Berat

KONSTATOJ SE :

Bazuar në kontrollin e ushtruar në Degën e Doganës Berat nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me shkresën Nr.11155/10 prot, datë04.11.2025 me lëndë:"Dërgohet Raporti Final i Auditimit" të protokolluar në Degën e Doganës Berat me nr.1150/9prot., datë06.11.2025 për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2024, në çështjen "Auditimi i procedurave të ndjekura për mbikqyrjen dhe kontrollin e operatorëve ekonomik" rezulton se:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Dogana Berat për operatorët ekonomik, lidhur me autorizimet për regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë me kodin e procedurës së zgjeruar \*5300\* rastet e mosdhënies së destinacionit doganor të konstatuara janë:

Operatori "SHOESERY - SHPK" me Nipt L930270011, përfaqësuar nga agjencia doganore "Ben Impex & CO", me kod J002, pajisur me autorizimin nr. P20190726/1407/1, rezulton se nuk i ka dhënë destinacion brenda afatit të përcaktuar në autorizim sasisë prej 240 kg "fustela", me vlerë 225 euro dhe detyrim në shumën 9,952 lekë.

Autorizimi	Procedura	R	Date	6 shifror	Përshkrimi	P neto	Vlera	Detyrimi
P20190726/1407/1	5300	3040	9-Aug-19	82089000	3 seri-fustela art.1480,1481,1482	70	75	3,309
P20190726/1407/1	5300	3519	16-Sep-19	82089000	5 seri-fustela art.9810.9811,1302,1182/1184,1484,1553. 5 kuti kartoni ne 1 palete	170	150	6,643
						240	225	9,952

Adresa: Ish Kombinati i Tekstileve, Berat

www.dogana.gov.al

Në zbatim të urdhërit të ngritur nga Kryetari i Degës Doganore nr. 1150/10 prot., datë 06.11.2025 nga doganierët e regjimit (Zyrës së Mbikqytjes) u njoftua operatori për fillimin e procedurës administrative nr.2766 prot., datë 24.12.2025 të Degës Doganore Berat. U kthye zarfi me shënimin "Marresi i objektit ka vdekur".

U morën masat për verifikimin e artikujve të sipër cituar me urdhër verifikimi nr.496 prot., date 20.02.2026. Grupi i kontrollit u paraqit pranë ambjenteve të operatorit ku u konstatua se subjekti nuk ushron më aktivitet në adresën e regjistruar, pasi në ambient ushtron aktivitet një biznes tjetër. Për këtë u mbajt procesverbali me nr.496/2 prot., date 20.02.2026, në mungesë të operatorit ekonomik.

Për sa më sipër referuar sistemit Asycuda Word, nuk i ka dhënë destinacion vijues artikujve të mësipër. Mbashtetur në ligjin 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", neni 250/1/a pika 1. Shkelje doganore: a) kundërvajtjet administrative. Subjekti penalizohet sipas neni 253/b Kundërvajtje të kryera me dashje", neni 258/1/a, të Kodit Doganor, detyrimin prej 9,952 Lekë si dhe në masën 3-fish penaltitet në shumën 29,856 lekë. U mbajt nga doganierët e Degës Doganore Berat procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore Nr. 0006760 serial datë 06.03.2026.

Akti i konstatimit 0006760 serial datë 06.03.2026 është njoftuar me shkresë Nr.666/1 prot.datë 06.03.2026 me njoftimin: "Per sa me siper ne zbatim te procedurave ligjore te parashikuara ne Ligjit Nr. 102 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë". i ndryshuar, neni 273 e vijues dhe ne zbatim te nenit 161 të VKM-së nr.651, datë 10.11.2017 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", keni të drejtë që brenda 10 diteve nga informimi, nga e nesërmyja e marrjes së njoftimit, për të paraqitur pretendimet/kundërshtimet (prova, mendimet etj) tuaja me shkrim në sekretarinë e Degës së Doganës Berat. Me përfundimin e afatit të lartpërmendur, Dega e Doganës Berat do të procedojë me marrjen e akteve administrative të lartpërmendur. Bashkëlidhur procesverbali për verifikimin e kundërvajtjes administrative doganore Nr. 0006760 serial datë 06.03.2026.

Lajmërimi i dërgimit postar me RR 815 784 712 AA bashkë me zarfin për shkresën e njoftimit Nr.666/1 prot.datë 06.03.2026 janë kthyer pas me mbishkrimin "ka ndëruar jetë".

Në mënyrë që të konsiderohet i njoftuar subjekti referuar Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" nga Dega Doganore Berat u bë i mundur njoftimi publik nëpërmjet afishimit dhe shpalljes në sallën e pranimit të operatorëve ekonomik pranë Degës Doganore Berat me nr. 666/3 prot., datë 17.03.2026 për jo me pak se 10 ditë dhe u bë kërkesë në Bashkinë Berat për afishimin dhe shpalljen në steden e njoftimeve të këtyre njoftimeve dhe informimi për datën e shpalljes.

Me shkresë Nr.1826/1 prot., datë 25.03.2026 ose Nr. 666/4 prot., datë 26.03.2026 hyrje në Degën Doganore Berat Bashkia e Beratit ka kthyer përgjigje për afishimin e njoftimit më datë 24.03.2026. Duke qene se kanë kaluar 10 ditë nga data e shpalljes publike të njoftimit vendosa:

VENDOSA:

Subjekti: "SHOESERY SHPK" shpk, me Nipt:L930270011 , të shpallet debitor si më poshtë :

• Detyrimin doganor	9,952	Lekë
• Penalitet :	29.856	Lekë
Total	39,808	Lekë

- Zyra e Financës dhe e Borsit Doganor, të kryejë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse.
- Kundër këtij vendimi, subjekti: "SHOESERY SHPK" shpk, me Nipt:L930270011 , lejohet të ushrojë ankimim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në dijeni e këtij vendimi pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave Tiranë, duke paguar shumën e përgjithshme të detyrimit (nëse ka) , si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e përgjithshme të sanksioneve të aplikuara për shkeljen në objekt, në zbatim të nenin 282 të Ligjit Nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

KRYETARI I DEGËS DOGANORE BERAT

